

SYLLABUS I KURSIT EXTRAKURRIKULAR

Njësia universitare	Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri (QEQ)
Programi	Energjia e ripërtëritshme dhe qëndrueshmëria Menaxhimi i Energjisë dhe i Mjedisit
Emri i kursit	PROCESET E GJELBRA PËR QËNDRUESHMËRI
Statusi i kursit	Zgjedhor
Numri i orëve në javë	2
Vlera në kredi – ECTS	5
Konsultimet	E Enjte, 15-16, FSHMN, Departamenti i Kimisë, Kab. 3
Instruktori i kursit	Prof. Dr. Majlinda Daci Ajvazi

Përshkrimi i kursit	<p>Ky kurs fokusohet në të kuptuarit e proceseve të gjelbëra dhe përmes zbatimit të parimeve të këtyre proceseve të reduktohen ose eliminohen rreziqet. Meqenëse këto procese kanë një qasje pro-aktive në parandalimin e ndotjes, ato synojnë ndotjen në fazën e projektimit, pra para se ajo të fillojë. Nëse mësojmë të zhvillojmë produkte dhe materiale ashtu që mos të përdorim substanca të rrezikshme, atëherë shumë nga mbetjet, rreziqet dhe kostot mund të evitohen. Ky kurs do të përqendrohet në parimet dhe konceptet e proceseve të gjelbëra; Mardhëniet e energjisë; Uji si tretësi i gjelbër themelor; Ajri dhe atmosfera; Gjeosfera; Antrosfera; Mbetjet: prodhimi, problemet dhe parandalimi; Zhvillimi i teknologjive më të gjelbra; Studimi i rasteve industriale; Materialet e papërpunuara: shfrytëzimi maksimal i materialeve të ripërtëritshme dhe atyre biologjike; Dhjetë urdhëresat e qëndrueshmërisë.</p>
Qëllimet e kursit	<p>Të kuptojmë rëndësinë e proceseve të gjelbëra për qëndrueshmëri. Të hartojmë dhe interpretojmë rrugë më të gjelbëra për proceset tradicionale teknologjike, pasi që nuk mund të mohohet se në vitet e kaluara, madje edhe për momentin, ka keqpërdorime në shumë aspekte, siç është lirimi i ndotësve dhe substancave toksike, prodhimi i materialeve jobiodegraduese, duke rezultuar në dëmtim të mjedisit, të gjallesave përfshirë këtu edhe njerëzit.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorin të gjithë principet e teknologjive të gjelbëra dhe të kuptojnë se pse ato janë aq thelbësore. • Dijnë ti përdorin ato principe në situata të reja dhe përmes tyre ti zgjidhin problemet dhe ti implementojnë ato në "botën reale". • Zbatojnë në mënyrë të pavarur këto parime në punën e tyre të përditshme. • Paraqesin shembuj të sukseshëm të teknologjive të gjelbëra. • Tregojnë se si e ardhmja mund të jetë ndryshe: të identifikojnë reagjentët, tretësit dhe reaksionët që duhet dhe realisht mund të zëvendësohen me alternativa të gjelbëra. • Shpjegojnë qëndrueshmërinë.

Kontributi në ngarkesën e studentit (orë akademike)

Aktiviteti	Orë	Javë	Total
Ligjërata	2	12	24
Ushtrime numerike (brenda ligjëratave)	-	-	-
Ushtrime laboratorike	-	-	-
Kontakti me mësimdhënësin (konsultimet/korrigjimet)	1	15	15
Ekskursioni	8	1	8
Vlerësimi i ndërmjetëm	2	2	4

Koha për vetëstudim	4	15	60
Përgatitja për vlerësimin përfundimtar	4	1	4
Detyra	1	6	6
Prezantimi i seminarit dhe vlerësimi final	2	1	2
TOTAL			123

Mënyra e zhvillimit të kursit | Kursi do të organizohet në ligjërata javore dhe në sesione të konsultimit. Shtjellimi i materialit të kursit do të bëhet nëpërmjet ligjëratave interaktive, detyrave, kuzeve dhe seminarit.

Plani i detajuar i organizimit të kursit

Java	Ligjërata, vlerësimi përkatësisht lloji i aktivitetit	Literatura bazë (B)	Dorëzimi i detyrave
1	Kimia e Mjedisit dhe Kimia e Gjelbër	B1. Kapitulli I B2. Kapitulli I	
2	Mardhëniet e energjisë	B1. Kapitulli VI	Detyra 1
3	Uji, tretësi i gjelbër themelor: përdorimi i tij dhe Kimia Mjedisore, Kuiz 1	B1. Kapitulli VII	
4	Ajri dhe Atmosfera	B1. Kapitulli VIII	Detyra 2
5	Gjeosfera, dheu dhe prodhimi i ushqimit: Revolucioni i dytë i gjelbër, Kuiz 2	B1. Kapitulli X	
6	Testi i ndërmjetëm I		
7	Drejt një antrosfere më të gjelbër përmes ekologjisë industriale	B1. Kapitulli XI	Detyra 3
8	Mbeturinat: prodhimi, problemet dhe parandalimi, Kuiz 3	B2. Kapitulli II	
9	Matja dhe kontrolli i performancës mjedisore	B2: Kapitulli III	Detyra 4
10	Zhvillimi i teknologjive të gjelbëra, Kuiz 4	B2. Kapitulli VII	
11	Studimet e rasteve industriale	B2. Kapitulli IX	Detyra 5
12	Testi i ndërmjetëm II		
13	Materialet e papërpunuara: shfrytëzimi maksimal i materialeve të ripërritëshme dhe atyre biologjike	B1. Kapitulli	
14	Dhjetë urdhëresat e qëndrueshmërisë	B1. Kapitulli XIV	Detyra 6
15	Prezantimi i Seminarit dhe vlerësimi final		

Literatura

Literatura bazë (B) (B1, B2 do të ofrohet në verzionin elektronik, Literaturën tjetër studentët mund ta sigurojnë nga interneti, libraritë ose bibliotekat)	[B1] S. E. Manahan: Green Chemistry and the ten commandments of sustainability, ChemChar Research, Inc. 2005. [B2] M. Lancaster: Green Chemistry: An Introductory Text, Royal Society of Chemistry, 2013.
Literatura shtesë (SH)	[Sh1] A. S. Matlack, A. P. Dicks: Problem-Solving Exercises in Green and Sustainable Chemistry, CRC, 2016.
Mënyra e dhënies së	Studentët duhet të jenë të rregullt në ndjekjen e ligjëratave, aktiv në kuize, të

provimit	<p>bëjnë kryerjen e detyrave me kohë, të përgatisin teknikisht dhe ta prezantojnë seminarin para kolegëve.</p> <p>Vlerësimi i vazhdueshëm i studentëve përfshin organizimin e kuizeve periodike, detyrave, prezantimin e seminareve dhe vlerësimet formative. Pikët të cilat mund të arrihen nëpërmjet aktiviteteve të tilla dhe provimit përfundimtar janë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vijueshmëria 5 pikë • Kuizet 10 pikë • Detyrat 15 pikë • Testi i ndërmjetëm I 25 pikë • Testi i ndërmjetëm II 25 pikë • Seminari, Vlerësimi final 20 pikë <p>Notat të cilat mund të marrin studentët të cilën e kalojnë me sukses provimin:</p> <table border="1" data-bbox="516 695 1370 995"> <thead> <tr> <th>Përqindja e pikëve (%)</th> <th>Nota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>95-100</td> <td>10 (shkëlqyeshëm)</td> </tr> <tr> <td>85-94</td> <td>9 (shkëlqyeshëm)</td> </tr> <tr> <td>75-84</td> <td>8 (shumë mirë)</td> </tr> <tr> <td>65-74</td> <td>7 (mirë)</td> </tr> <tr> <td>50-64</td> <td>6 (mjaftueshëm)</td> </tr> <tr> <td>1-49</td> <td>5 (pamjaftueshëm)</td> </tr> </tbody> </table>	Përqindja e pikëve (%)	Nota	95-100	10 (shkëlqyeshëm)	85-94	9 (shkëlqyeshëm)	75-84	8 (shumë mirë)	65-74	7 (mirë)	50-64	6 (mjaftueshëm)	1-49	5 (pamjaftueshëm)
Përqindja e pikëve (%)	Nota														
95-100	10 (shkëlqyeshëm)														
85-94	9 (shkëlqyeshëm)														
75-84	8 (shumë mirë)														
65-74	7 (mirë)														
50-64	6 (mjaftueshëm)														
1-49	5 (pamjaftueshëm)														
Studentët me nevoja të veçanta	<p>Studentët që kanë nevoja të veçanta në ndonjë aspekt fizik apo psikologjik mund të caktojnë një termin për konsultime brenda orarit të konsultimeve</p>														
Rregullat akademike për studentë	<p>Studentët inkurajohen të bashkëpunojnë në kryerjen e obligimeve të parapara në kuadër të kursit, por është rreptësisht i ndaluar kopjimi i përgjigjes së kuizeve, detyrave, seminareve dhe testeve. Nëse konstatohet kopjimi, studenti do të vlerësohet me zero pikë në aktivitetin përkatës.</p> <p>Sjellja e përsëritur në kundërshtim me përgjegjësitë e parapara në Statutin e Universiteti të Prishtinës do të rezultojë në largimin e studentit nga kursi.</p> <p>Në hapësirat e mësimit ndalohet pirja e duhanit, kurse gjatë kohës së mësimit ndalohet konsumimi i ushqimit dhe pijeve. Shfrytëzimi i telefonit gjatë kohës së ligjëratave dhe aktiviteteve tjera mësimore është gjithashtu i ndaluar.</p>														